

OBJEKTIVAT FORMUES TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.\

a. Profili kulturor dhe profesional i studimit në përfundim të programit mësimor

Programi i studimit: Bachelor në Infermieri të Përgjithshme synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën infermieristike. Ai ka për objektiv të përgatisë infermierë të përgjithshëm me formim të plotë për të ofruar kujdes shëndetësor bazë për cdo patologji dhe për cdo grup-moshe (nga adoleshenca e deri në fund të moshës së tretë).

Gjithashtu i përgatit studentët të realizojnë ndërhyrje bazë te pacientët si dhe ndihmon në përmbushjen e detyrave bazë të kërkuara prej një infermieri profesionist.

Studentët do të aftësohen gjithashtu për të komunikuar në mënyrë profesionale edhe me publikun për teknikat infermiore që aplikohen në cdo pavion, duke fituar mjeshtëri dhe përvojë në komunikimin formal dhe informal me studentë, infermierë, mjekë dhe specialistë të kujdesit shëndetësor.

Objektivat e këtij programi përfshijnë:

- Plane bashkëkohore të asistencës infermiore në praktikën infermiore.
- Të menduarit kritik në gjykimet dhe vendim-marrjet profesionale.
- Të mësuarit e bazuar në problem.
- Komunikimin efektiv me të tjerët.
- Kontribuimin në rritjen e kapaciteteve shëndetësore komunitare.

Në përfundim të programit të studimeve studentët do të marrin diplomën:

Bachelor në Infermieri të Përgjithshme

b. Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor.

Në përfundim të programit mësimor studentët do të jenë të aftë:

- Të kryejnë vlerësimin infermior të përgjithshëm dhe instrumental të pacientëve.
- Te menaxhojnë terapinë farmakologjike dhe analgjezike.
- Të ofrojnë edukim shëndetësor dhe terapeutik pacientit dhe familjarëve.
- Të ofrojnë mbështetje psikologjike dhe garantim të privacisë.
- Të monitorojnë dhe të kryejnë mjekimin e plagëve kirurgjikale.
- Të vlerësojnë dhe kontrollojnë rrezikun për infeksione.
- Të kontrollojnë dietën.
- Të vlerësojnë, parandalojnë dhe menaxhojnë rrezikun për tromboza.
- Të parandalojnë dekubituset.
- Të përvetsojnë teknikat infermiore bashkëkohore të kujdesit në sëmundjet e adultëve.
- Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të sëmundjeve dhe kujdesit infermior
- Të hartojnë dhe zbatojnë planet e personalizuara të asistencës infermiore
- Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit infermior të pacientëve adultë/geriatrikë me patologji të ndryshme.
- Të njohin dhe aplikojnë teknikat infermiore më të avancuara të kohës.
- Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit infermior në fushën e këtyre patologjive.
- Të formojnë shprehje për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të sugjerojnë rekomandime për ndërhyrje në sistem.

c. Mundësitë për punësim

Në përfundim të këtij programi të ciklit të parë të studimeve studentët do të kenë njohuri, vizion, aftësi dhe eksperiencë të mjaftueshme për të ofruar një kujdes infermieror me cilësi të lartë, bashkëkohor, të bazuar mbi gjykimin kritik të fakteve tek një spektër i gjerë pacientësh në çdo hallkë të shërbimeve shëndetësore:

- Në cdo repart (Patologji, Kirurgji, Pediatri, Obstetrikë-Gjinekologji, Sëmundje infektive, Terapi intensive, Urgjencë etj.) në Spital Rajonal, rrethi apo Spitalet Universitare
- Shërbimi shëndetësor dytësor
- Spitali Psikiatrik i Vlorës
- Kompanitë e kujdesit shëndetësor, spitale, qendra shëndetësore, shtetërore dhe private, lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.